

VENOVAN E SHITË I PLOTËFUQISHËM
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAÇ

P.nr.989/2018

27.09.2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtarë ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamentit i Përgjithshëm PP/II.nr.1312-7/2018 të datës 24.07.2018, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.22.08.2018 solli:

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj Ferizaj -Departamentit i Përgjithshëm PP/II.nr.1312-7/2018 të datës 24.07.2018, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, lindur me datë [REDAKTUAR] në të njëtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar vozitës, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personale [REDAKTUAR], mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepe - me datën 14 Qershor 2018, rreth orës 16:20, minuta, në fshatin Prelez, Komuna Ferizaj, duke drejtuar automjetin, e tipit " Opel Combo ", ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], nga pakujdesia rrezikon jetën e njerëzëve dhe pasurin ashtu që në kundërshtim me nenin 41 par 1 të ligjit mbi trafikun publik, ndërmerr veprimin e lëvizjes mbrapa për të dal nga parkingu dhe për tu kyçur në rrugën Ferizaj-Prishtinë, pa u siguruar mirë se me atë veprim mundë të rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, për pasoj me pjesën e pasme e godet në drejt të pasme automjetin e tipit " VW Jetta ", ngjyrë e kuqe, me targa [REDAKTUAR], të cilën e drejtonte [REDAKTUAR], ku përveq dëmeve materiale lëndime të lehta trupore pëson pasagjerja e njësisë B e dëmtuara [REDAKTUAR] e cila në atë moment e kishte derën e hapur dhe këmbën e majtë e kishte jashtë automjetit,-

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë e akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

E dëmtuara [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 60,88 Euro, dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari të paguaj edhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamentit i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.1312-7/2018 të datës 24.07.2018, ka akuzuar [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPK-së dhe në aktakuzë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësishtë konstatimin e mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 02.07.2018, dhe ekspertit mjeko ligjor i datës 30.06.2018, si dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së , e dëmtuara [REDACTED]
[REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike
është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor
është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit
39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e viktmave të krimit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.989/18 me datë 22.08.2018

Zyrtare Ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK: Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh,
nga dita e pranimin të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj
gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm
dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.